

DOMOSDOSH MËRIA E KRIJIMIT TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË GJENDJEN AKTUALE TË ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE ADMINISTRATIVE

Ina PURAVELLI dhe Julejda GËRXHI *

Abstrakt: Ky punim synon të nxjerrë në pah nevojën e krijimit të një strukture të re gjyqësore, Gjykatës Administrative, e cila do të jetë e specializuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet me natyrë administrative që hasen shpesh midis administratës publike dhe subjekteve private. Punimi bën një krahasim midis mënyrës aktuale të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të administratës publike dhe subjekteve private, në seksionet e për zgjidhjen e çështjeve administrative pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, dhe zgjidhjeve që do të ofrojë një organ i specializuar gjyqësor siç është Gjykata Administrative. Po ashtu avantazhet dhe eficienta që do të sjellë krijimi i një Gjykate Administrative, do të paraqiten nëpërmjet përpunimit, analizimit të situatës aktuale dhe projektligjit për krijimin e Gjykatës Administrative. Gjithashtu, në punim do të kombinohet analizimi i rezultatit të nxjerrë, me legjislacionin aktual mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me natyrë administrative në Shqipëri.

Nëpërmjet këtij punimi synohet pasqyrimi i gjendjes reale të mungesës së një hallke të veçantë në sistemin e drejtësisë, që zgjidh mosmarrëveshjet me natyrë administrative mes administratës publike dhe subjekteve private, që është konsideruar si shkak për krijimin e raporteve të vështira mes tyre. Domosdoshmëria e krijimit të Gjykatës Administrative në legjislacionin shqiptar është kthyer në një objektiv të pashmangshëm, me qëllimin e vetëm për të krijuar një klimë sa më të qetë për mbarëvajtjen e raporteve mes administratës publike dhe subjekteve private. Po ashtu, ky punim synon të shërbejë si një nxitje për të vlerësuar drejt nevojën dhe domosdoshmërinë e krijimit të Gjykatës Administrative, duke qenë se Shqipëria është vendi i fundit në rajon që nuk ka ende një Gjykatë Administrative.

Fjalët çelës: Gjykatë administrative, administratë publike, mosmarrëveshje administrative, subjekte private, legjislacion.

1. Hyrje

Shqyrtimi ligjor i vendimeve administrative nga gjykata të pavarura është një parim demokratik i pranuar, i pranishëm në praktikën kryesore europiane dhe një kontribut i rëndësishëm për të siguruar rendin, veçanërisht për të mbrojtur të drejtat individuale përballë administratës.¹ Për më tepër, drejtësia administrative luan një rol vendimtar për zhvillimin ekonomik të një vendi. Për këtë arsye u pa i nevojshëm reformimi i kuadrit të përgjithshëm ligjor administrativ në Shqipëri

* Ina Puravelli dhe Julejda Gërxi, Universiteti Pavarësia, Vlorë.

¹ Ky parim është në vetvete pjesë e pjesë e parimit të përgjithshëm të sigurimit të mjeteve efektive të ankimit.

në kuadër të reformës në drejtësi. Nevoja e krijimit të Gjykatës Administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Nëpërmjet saj synohet krijimi i kushteve të përshtatshme për një shqyrtim efektiv duke vënë në vend të drejtat e cënuara nga veprimet dhe / apo aktet administrative të nxjerra nga organet e administratës publike. Kontrolli gjyqësor i veprimeve publike administrative nga një gjyqësor administrativ që funksionon mirë përveç pikëpamjes strikte ligjore të çështjeve individuale, është edhe një forcë stimuluese për modernizimin e administratës publike, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve të saj dhe si pasojë, rritjen e besimit të qytetarëve në efektshmërinë e institucioneve shtetërore.

2. Shqyrtimi ligjor i akteve administrative nga gjykatat e pavarura

Për të realizuar këtë punim u bë një krahasim midis mënyrës aktuale të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të biznesit dhe administratës shtetërore dhe mënyrës si do të zgjidheshin ato me anë të një organi të specializuar gjyqësor siç është Gjykata Administrative. Shqyrtimi gjyqësor i veprimtarisë së organeve qeverisëse e ka origjinën e vet në filozofinë e shtetit që qeveriset dhe kufizohet nga ligji dhe bazohet tek parimi i epërsisë së ligjit. Në ditët e sotme, një shtet ligjor nuk mund të mendohet pa akses për të gjithë qytetarët tek një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar në bazë të ligjit dhe e aftë për të përmbushur kërkesat e zhvillimit të një gjykimi të drejtë.

Qëllimi i shqyrtimit gjyqësor synon të përfshijë brenda juridiksionit të gjykatave administrative të gjitha paditë që lidhen me çështje administrative, dhe po ashtu të sigurojë një mbrojtje të gjerë ligjore ndaj të gjitha veprimeve administrative, pavarësisht formës së tyre si aktet individuale, normative ose kontrata administrative. Kontrolli si i “akteve të qeverisë”² ashtu edhe i akteve të bazuara në diskrecion nga gjykata e apelit, si shkallë e parë, si dhe shmangia e konflikteve të kompetencës me gjykatat e zakonshme duke i transferuar paditë që paraqiten gabim në gjykatën kompetente, të cilës i përket çështja, janë një faktor shumë i rëndësishëm efektiviteti. Si i tillë, roli i shqyrtimit gjyqësor të veprimtarisë administrative është të mbrojë të drejtat e qytetarëve, por edhe të mbrojë interesin publik dhe rendin ligjor.

Krahas këtij roli mbrojtës, kontrolli gjyqësor shihet si një mjet i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së administrimit dhe qeverisjes së mirë. Zgjerimi i sektorit publik dhe rritja e kompleksitetit të vendim-marrjes administrative ka një ndikim të dyfishtë: nga njëra anë sjell forma të reja të aktivitetit administrativ dhe rritje të kërkesës për fleksibilitet të administratës në shërbim të interesit publik dhe nga ana tjetër efektet e një zgjerimi të tillë mbi jetën individuale janë duke u

² Projekt-ligji për “Organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

rritur vazhdimisht. Në Shqipëri, shqyrtimi gjyqësor i akteve administrative aktualisht i është ngarkuar sistemit gjyqësor të zakonshëm. Në përgjithësi, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile zbatohen për gjykimet e çështjeve administrative, përveç kur në Kod parashikohet ndryshe .

Termi “çështje administrative” mund t’i referohet anës lëndore të çështjes ose cilësimit formal duke iu nënshtruar dispozitave të veçanta procedurale.³ Megjithatë, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, nuk i përcaktojnë qartë çështjet që duhet të konsiderohen si çështje administrative. Për pasojë, mund të ketë praktika të ndryshme të llogaritjes së numrit të “çështjeve administrative” në gjykata. Megjithatë, për qëllimet e këtij studimi janë marrë për bazë shifrat përkatëse të dhëna përkatësisht nga gjykatat dhe Ministria e Drejtësisë.

Mosmarrëveshjet administrative mund të paraqiten për shqyrtim gjyqësor, nëse:

- organi administrativ ka vepruar në cilësinë e tij si ushtrues i të drejtave sovrane/autoritetit shtetëror;
- paditësi kërkon anulimin ose ndryshimin e aktit administrativ, ose kundërshton refuzimin e organit administrativ për nxjerrjen e një akti administrativ ose mosshqyrtimin nga organi administrativ të ankesës së paditësit brenda afatit të caktuar, dhe
- paditësi argumenton që akti administrativ është i paligjshëm dhe kjo cenon interesat dhe të drejtat e tij.⁴

Megjithatë, para paraqitjes së çështjes në gjykatë, paditësi duhet të kërkojë vendimin e organit më të lartë administrativ, që shqyrton ankesën në rrugë administrative, përveç kur ligji parashikon ankim të drejtpërdrejtë në gjykatë. Organi administrativ kompetent që ka nxjerrë ose nuk ka nxjerrë aktin administrativ kundër të cilit është bërë ankimi duhet të vendosë mbi ankimin administrativ brenda një muaji nga paraqitja e tij. Nëse ai nuk e pranon ankimin, ai është i detyruar ta transferojë ankimin tek organi epror, i cili duhet të vendosë në lidhje me ankimin brenda dy javësh. Nëse organet administrative nuk u përmbahen afateve, ankimuesi mund t’i drejtohet drejtpërdrejt gjykatës.

Sistemi gjyqësor shqiptar është i organizuar në tre shkallë gjykimi, që janë gjykatat e rretheve gjyqësore (aktualisht 29), gjykatat e apelit (aktualisht 6) dhe Gjykata e Lartë. Janë këto gjykata që aktualisht zgjidhin mosmarrëveshjet administrative. Për gjykimin e çështjeve administrative të shkallës së parë, janë krijuar seksione të veçanta në 17 gjykata të rretheve gjyqësore, që kanë juridiksion të zgjeruar territorial me qëllim që të mbulojnë zonat e gjykatave të tjera të rretheve gjyqësore që nuk kanë të tilla seksione.

³ Kodi i Procedurës Civile.

⁴ Kodi i Procedurave Administrative.


Në pjesën më të madhe të gjykatave, gjyqtarët e seksioneve administrative duhet të shqyrtojnë edhe çështje jo-administrative në një masë të konsiderueshme, për shkak të numrit të paktë të çështjeve administrative dhe të gjyqtarëve në gjykatat e tyre. Në disa nga gjykatat e rrethit, veçanërisht në gjykatat më të vogla, të gjitha çështjet shpërndahen ndërmjet të gjithë gjyqtarëve megjithë ekzistencën formale të një seksioni administrativ, me qëllim që të arrihet një shpërndarje më e barabartë e ngarkesës së punës. Çështjet administrative ashtu si çështjet e tjera civile gjykohen nga një gjyqtar i vetëm, nëse vlera nuk i kalon njëzet milion lekë, përndryshe nga një trup gjykues me tre gjyqtarë. Aktualisht paditë për marrëdhëniet e punësimit ngrihen në seksionin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë që përfshin territorin ku punëmarrësi kryen zakonisht punën e tij.

Tabela 1. Çështje administrative të gjykuara në gjykatat e rretheve gjyqësore

	2005	2006	2007	2008	Mesatare
Berat	64	67	55	70	64
Dibra	19	75	66	89	62
Durrës	80	113	154	156	126
Elbasan	68	147	233	186	158
Fier	49	91	98	103	85
Gjirokastra	55	109	101	139	101
Kavajë	-	5	8	20	11
Korca	205	270	254	432	290
Krujë	19	18	20	42	25
Kukës	24	62	38	83	52
Kurbin	-	0	0	0	0
Lezha	32	67	133	228	115
Lushnjë	36	72	92	94	73
Mat	10	31	35	26	25
Pogradec	-	18	11	18	16
Pukë	-	4	1	5	3
Sarandë	36	28	109	200	93
Shkodër	316	281	279	425	325
Tirana	497	1261	1824	2652	1558
Tropojë	9	7	33	82	33
Vlora	149	230	260	413	263
Totali	1668	2956	3804	5463	3478

Numri i pergjithshem i ceshtjeve administrative te gjykuara (depozituar per here te pare ose kthyer nga nje shkalle me e larte) ne vit ka ndryshuar brenda viteve 2005 deri 2008 nga 1668 deri 5463, domethene, me nje mesatare prej 3478.⁵

Grafiku 1



Në gjykatat e apelit, gjyqtarët e specializuar për çështjet administrative duhet të marrin pjesë në trup gjykues.⁶ Praktikisht të gjithë gjyqtarët e gjykatave të apelit që kanë ndjekur trajnime shtesë për çështjet administrative, konsiderohen të specializuar në këtë fushë dhe marrin pjesë në gjykimin e çështjeve administrative. Çështjet gjykohen nga trupa gjykues me tre gjyqtarë. Nuk ka të dhëna mbi numrin e çështjeve administrative në Gjykatën e Apelit. Në lidhje me Gjykatën e Lartë nuk ka dispozita që të kërkojnë specializim. Praktikisht, çështjet administrative shqyrtohen nga të gjithë gjyqtarët e kolegjit civil. Çështjet gjykohen me trup gjykues me pesë gjyqtarë. Nuk ka të dhëna mbi numrin e çështjeve administrative në Gjykatën e Lartë. Pra organizimi aktual i shqyrtimit administrativ të akteve administrative në Shqipëri i referohet një juridiksioni që është i integruar në sistemin gjyqësor të zakonshëm.

⁵ Ministria e Drejtësisë.

⁶ Neni 333 KPC.

Ky organizim perben nje nga modelet e ofruara te zgjidhjes se mosmarrveshjeve administrative, ne disa vende te Europes,⁷ krahas modelit te nje juridiksioni administrativ autonom. Keto modele shpesh jane vendosur kundrejt njeri-tjetrit duke e specifikuar juridiksionin administrativ autonom si nje juridiksion administrativ “te specializuar”. Megjithate, kjo kundervenie nuk korrespondon domosdoshmerisht me ndonje ndryshim thelbesor, pasi edhe sistemi gjyqesor i zakonshem mund te siguroje nje shkalle te larte specializimi duke krijuar dhoma ose seksione te cheshtjeve administrative, ashtu siq kanë bere shumica e vendeve qe kanë ruajtur unitetin e juridiksionit. Sidoqoftë, persa i takon perputhshmerise me standardet europiane, te dy modelet jane te barabarte.

Vendimi i gjykatës qe shqyrton nje akt administrativ, te paktën ne cheshtjet e rendesishme, duhet t’i nenshtrohet ankimit ne nje gjykate me te larte. Krijimi i gjykatave administrative, kerkon transferimin e gjykimeve perkate se nga objekti i gjykatave te juridiksionit te zakonshem, dhe ky perben nje ndryshim te konsiderueshem ne sistemin gjyqesor, gjë qe kerkon shume perpjekje dhe shpenzime. Per pasojë, nevoja per keto gjykata duhet te shqyrtohet me kujdes para hartimit te legjislacionit per krijimin e tyre. Me qellim qe te vendoset nese jane te keshillueshme gjykatat autonome te specializuara per nje fushë te caktuar te ligjit, faktorët e meposhtem duhet te jene me kryesorët qe duhet marrë parasysh:

- Nevoja e specializimit ne fushën perkate se te ligjit;
- Arsye te mundshme specifike ne favor te gjykatave autonome ne lidhje me fushën perkate se te ligjit;
- Ngarkesa perkate se e cheshtjeve;
- Efektet mbi gjykatat e zakonshme;
- Efektet mbi mundesinë per t’iu drejtuar gjykatës.

Po t’i referohemi projektligjit te propozuar per ngritjen e gjykatave administrative ne Shqipëri verehet se ne te jane parashikuar si gjykata kompetente per gjykimin e mosmarrveshjeve administrative:⁸ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Gjykata e Lartë. Ne parashikimet per organizimin e gjykatave administrative behet referenca me dispozitat e ligjit per organizimin e pushtetit gjyqesor me perjashtim te rastit kur ne ketë ligj parashikohet ndryshe, ne lidhje me kriteret e emerimit dhe te karrierës së gjyqtarëve, statusi i tyre, pergjegjësia per shkeljet disiplinore, masat disiplinore, procedimi disiplinor, administrimi i shërbimeve ne gjykate, si dhe riorganizimi gjyqesor dhe delegimi i gjyqtarëve. Përse i perket perberjes së trupit gjykues te Gjykatës Administrative te Shkallës së Parë, ne projektligj është parashikuar gjykimi me trup gjykues te perberë nga nje gjyqtar dhe trup gjykues te perberë nga tre gjyqtarë. Gjykimi me nje gjyqtar te vetëm behet ne rastet kur kemi padi me vlerë me te vogël

⁷ Galligan, Discretionary powers, viti 1996

⁸ Projektligji per krijimin e gjykatave administrative

apo të barabartë me dy milionë lekë si dhe ato që i përkasin fushës së marrëdhënieve të punës. Gjykata e Apelit Administrativ gjykon me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë për paditë ndaj aktit nënligjor normativ dhe nga tre gjyqtarë për çështjet e tjera.

Në projektligj, parashikohen gjithashtu edhe kompetencat lëndore, funksionale dhe tokësore të Gjykatës Administrative. Përsa i përket kompetencës lëndore, Gjykata Administrative është kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lidhen me veprimet administrative, marrëdhëniet e punës të rregulluara nga Kodi i Punës, në të cilat punëdhënësi është një organ publik; si dhe një akt nënligjor normativ të organeve qendrore apo organeve të njësisve të qeverisjes vendore. Risi e sjellë nga ky projektligj, për herë të parë në legjislacionin shqiptar është parashikimi i kompetencës funksionale sipas shkallëve të gjykimit.

Për një gjykim sa më eficient dhe në mbrojtje të interesave të palëve, projektligji ka parashikuar edhe kompetencën tokësore sipas territorit në të cilin organi administrativ ka kryer veprimin administrativ ose në territorin e të cilës ka qendrën organi administrativ. Koncepti i “barrës së provës” në drejtësinë administrative ndryshon nga koncepti që mban e drejta procedurale civile apo penale. Në kontekstin e mosmarrëveshjeve administrative, barra e provës për të provuar ligjshmërinë e aktit të kundërshtuar, bie mbi organin administrativ. Ligji mund të përcaktojë kushtet me të cilat gjykata mund të imponojë barrën e provës mbi palët, që të sigurojë bashkëpunimin e tyre të nevojshëm. Duke iu referuar modeleve të aplikuara sot në botë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative si dhe projektligjit për ngritjen e gjykatave administrative mund të parashatrojmë disa nga përparësitë dhe mangësitë e ngritjes së këtyre gjykatave.

3. Avantazhet që ofron në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative Gjykata Administrative

Krijimi i gjykatës administrative, garanton që çështjet që i përkasin një fushe specifike të juridiksionit të gjykohen vetëm nga gjyqtarë të specializuar në këtë fushë. Duke u marrë shumë më shpesh me një gamë të kufizuar çështjesh, këta gjyqtarë mund të zhvillojnë dhe akumulojnë ekspertizën për të nxjerrë vendime me cilësi të lartë, që nuk do të kenë nevojë të ndryshohen nga shkallët më të larta, nëse kundër tyre bëhet ankim.⁹ Ato mund t’i gjykojnë këto mosmarrëveshje më me efikasitet dhe shpejtësi, pasi atyre u duhet më pak kohë për të hetuar dhe reflektuar mbi elementët themelore të çështjes; ato zhvillojnë praktika specifike për menaxhimin e çështjeve dhe ata mund t’i drejtojnë dhe orientojnë palët në fazat e para të gjykimit. Autoriteti i gjyqtarëve të specializuar ka mundësi më shumë të pranohet nga palët dhe avokatët, sidomos nëse ata vetë janë të specializuar apo me eksperiencë në fushën përkatëse.

⁹ Peter Cane, An introduction to administrative law, viti 1997.

Transferimi i juridiksionit për sfera të caktuara tek gjykatat administrative mund të rrisë edhe efikasitetin e gjyqtarëve në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, pasi atyre nuk do t'u duhej të futeshin në sfera specifike ku do të ishte e vështirë për të gjykuar si duhet raste kaq të rralla. Gjykatat administrative mund të kontribuojnë në njësimin e fushës përkatëse të juridiksionit. Gjyqtarët e specializuar do të ndikonin në pakësimin e mospërputhjeve në interpretimin dhe zbatimin e ligjit në fushën përkatëse, në saj të ekspertizës së tyre dhe numrit të paktë të gjyqtarëve.

Një praktikë gjyqësore më e qëndrueshme bën të mundur një siguri ligjore, risjell besimin në shtetin ligjor dhe pakëson çështjet gjyqësore në të ardhmen. Gjykatat administrative mund të jenë të dëshirueshme në lidhje me arritjen e një madhësie të përshtatshme për gjykatën. Studimet shkencore në vendet e ndryshme të Europës perëndimore nxorën përfundimin që efikasiteti optimal mund të arrihet nga gjykatat e një madhësie mesatare, ndërsa efikasiteti i gjykatave shumë të vogla si dhe i gjykatave shumë të mëdha çënohet nga mangësi të ndryshme për shkak të madhësisë përkatëse të vogël ose të madhe.

Kështu, në vend të pasjes së gjykatave të njësuara që janë shumë të mëdha, do të ishte më mirë të ngriheshin gjykata të veçanta, me kusht që edhe gjykatat administrative të mund të kenë natyrisht një madhësi të mjaftueshme. Po kështu, meqenëse ndërmjet juridiksionit të përgjithshëm dhe të specializuar administrativ në lidhje me rregullat procedurale, shkallët e gjykimit dhe për pasojë edhe në menaxhimin e çështjeve ka ndryshime, ndarja mund të jetë një zgjedhje më e mirë për të arritur një efikasitet optimal. Shqyrtimi gjyqësor i akteve administrative duhet të shtrihet për:

- Çdo akt normativ (nënligjor) të lëshuar nga një autoritet publik (që prek në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat dhe/ose interesat e ligjshme);
- Çdo akt individual administrativ i lëshuar nga një autoritet publik, që krijon, modifikon ose shfuqizon një marrëdhënie juridike;
- Çdo akt real, veprim material ose akt i brendshëm (që prek drejtpërdrejt të drejtat dhe/ose interesat e ligjshme);
- Çdo mosveprim apo refuzim nga ana e autoritetit publik për të vepruar në rastet kur autoriteti publik ka detyrim për të vepruar;
- Çdo proces gjyqësor lidhur me marrëdhëniet e punës që ka për palë autoritetin publik dhe punonjësit e vet;
- Çdo proces gjyqësor që ka të bëjë me lidhjen, interpretimin, ekzekutimin dhe zgjidhjen e kontratave që kanë për palë autoritetet publike;
- Kompensimin e dëmeve me natyrë monetare ose jo.

Ndërsa në lidhje me legjitimitimin njihen tri koncepte për akses në procedurat gjyqësore administrative:

- çdokush ka të drejtë për të kundërshtuar çdo veprim administrativ pa kërkesa të mëtejshme (*actio popularis*, nuk është shumë i përhapur në Europë);
- paditësi duhet të ketë një interes të ligjshëm të kualifikuar për të kundërshtuar një veprim administrativ (modeli francez, precedentë të Gjykatës së Drejtësisë);
- aksesit në gjykatë lejohet vetëm kur ka një pretendim për shkelje të të drejtave subjektive (modeli gjerman).

Një kombinim i sistemit gjerman (e drejta subjektive individuale) dhe francez (interes ligjor i kualifikuar), është çelësi për vendosjen e një koncepti të baraspeshuar për palën e interesuar. Ata që nuk preken në të drejtat e tyre subjektive ose interesat ligjore, nuk kanë të drejtën të ngrenë një padi administrative (legjitimiteti aktiv).¹⁰ Një institucion publik që padit një tjetër institucion publik nuk duhet të ketë të drejtën e padisë kur ato i përkasin të njëjtës varësi administrative. Nëse një numër aplikantësh ndajnë të njëjtin interes, pranohen paditë e përbashkëta (ligji francez). Për rrjedhojë shqyrtimi ligjor i akteve administrative nga gjykata të pavarura do të synojë të krijojë mundësinë për kontrollin e të gjitha akteve për infrastrukturën që kalojnë përmes një procesi licencimi, po ashtu rrit gjithashtu transparencën e vendimeve administrative dhe luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Krijimi i gjykatës administrative do të shërbejë si forcë stimuluese për modernizimin e administratës publike, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të administratës dhe rritjen e besimit të qytetarëve për institucionet shtetërore. Ajo që është edhe më e rëndësishme është kontributi për të siguruar rendin kushtetues, veçanërisht për të mbrojtur të drejtat individuale përballë administratës publike.

4. Disavantazhet e krijimit së gjykatave administrative

Ngritja e gjykatave administrative edhe pse është një faktor shumë i rëndësishëm në integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, duhet parë edhe në këndvështrimin e problematikave që mund të shkaktojë. Konkretisht shkalla e dëshirueshme e specializimit të gjyqtarëve për rezultatet e pritshme pozitive nuk kërkon domosdoshmërisht ngritjen e gjykatave administrative. Pika vendimtare është pasja e gjyqtarëve të specializuar për gjykimin e çështjeve përkatëse. Ngritja e gjykatave administrative sjell deri në një farë mase ngushtimin ose edhe kufizimin e mundësisë për t'iu drejtuar gjykatës. Numri i çështjeve në fushën specifike të juridiksionit zakonisht justifikon një numër më të pakët gjykatash nga sa janë në sistemin e zakonshëm gjyqësor.

Për pasojë, palët nga zonat e largëta do të duhet të përballojnë shpenzime më të larta dhe barrën e udhëtimeve më të gjata, gjë që mund t'u privojë atyre mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës në varësi të rrethanave konkrete. Gjithashtu nëse gjykata funksionon kryesisht si një gjykatë shëtitëse, efikasiteti administrativ do të binte dhe cilësia e veprimeve gjyqësore si dhe e vendimeve do të linte shumë për të dëshiruar. Ngritja e gjykatës administrative mund të

¹⁰ Wade&Forsyth, Administrative Law, viti 1998

shkaktojë mosmarrëveshje në lidhje me kompetencën ndërmjet gjykatave. Edhe nëse sfera ligjore e gjykatës administrative mund të ndahet nga pikëpamja teknike dhe lëndore nga sferat e tjera të ligjit, disa çështje me kompetencë të debatueshme nuk mund të evitohen. Këto mosmarrëveshje zakonisht shkaktojnë gjykime të ngadalta dhe shpenzime shtesë, dhe për pasojë pengojnë rritjen e pritshme të efikasitetit.

Krijimi i gjykatës administrative mund të dobësojë sistemin gjyqësor të zakonshëm. Në mënyrë të veçantë, efikasiteti i gjykatave të vogla të zakonshme mund të rrezikohet seriozisht nëse ngarkesa e tyre e çështjeve vazhdon të pakësohet. Për më tepër, mundësia e ndikimit reciprok pozitiv në dobi të gjykimit është shumë e ulët ndërmjet sistemeve gjyqësore të veçanta. Sa më shumë gjykata të specializuara dhe autonome të krijohen, aq më shumë do të pakësohet juridiksioni i gjerë dhe i pasur i gjykatave të zakonshme, gjë që ka qenë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e së drejtës. Ndarja e gjyqësorit në dy ose më shumë sisteme gjyqësore autonome ka mundësi që ta dobësojë pozitën e gjyqësorit brenda sistemit të balancës së pushteteve. Gjyqësori përbëhet vetëm nga një numër i vogël njerëzish, që duhet të mos bëjnë lobim për shkak të dinjitetit dhe postit të tyre.

Për pasojë, është gjithmonë rreziku i nënvlerësimit ose neglizhimit nga pushtetet e tjera, pavarësisht garancive kushtetuese për pavarësinë e tij. Nëse gjyqësori duhet të ndahet në pjesë, ky rrezik rritet, veçanërisht në lidhje me sistemet e gjykatave të specializuara. Në varësi të objektit të juridiksionit të specializuar, mund të jetë e vështirë të tërhiqen juristët e talentuar dhe të kualifikuar për gjykatat administrative, pasi juridiksioni i gjykatave të zakonshme siguron një zhvillim profesional më fleksibël dhe shërbimi në këto gjykata konsiderohet të japë shanse më të mira për karrierën dhe pozitën e tyre në profesion. Nëse gjykatat administrative ngrihen për fusha shumë të ngushta të juridiksionit, neutraliteti i gjykatave mund të kompromentohet nga zhvillimi i marrëdhënieve të ngushta dhe njohjeve personale ndërmjet gjyqtarëve të specializuar dhe avokatëve të specializuar që normalisht mbulojnë këto gjykata.

5. Konkluzione

Krijimi i gjykatave administrative mund të arrihet nëpërmjet një organizimi sa më të mirë të mundshëm të juridiksionit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative. Është e qartë nga shtjellimet e mësipërme që nuk mund të ketë një zgjidhje ideale, domethënë, një sistem gjyqësor efektiv dhe me sa më pak shpenzimeve, që të ketë gjykatë me juridiksion të plotë në çdo rreth dhe në të njëjtën kohë gjyqtarë shumë të specializuar. Zgjidhja më e mirë e mundshme mund të jetë një kompromis në balancimin e drejtë të interesave të kundërt, dhe duke marrë parasysh edhe mundësinë e realizimit në praktikë.

Krijimi i gjykatave autonome administrative do të ishte zgjidhja e duhur me qëllim:

- Garantimin që çështjet që i përkasin një fushë specifike të juridiksionit të gjykohen vetëm nga gjyqtarët e specializuar në këtë fushë.
- Kjo strukturë mund t'i gjykojë mosmarrëveshjet administrative më me efikasitet dhe shpejtësi, pasi atyre u duhet më pak kohë për të hetuar dhe reflektuar mbi elementët themelore të çështjes.
- Synimin në njësimin e fushës përkatëse të juridiksionit. Gjyqtarët e specializuar do të ndikonin në pakësimin e mospërputhjeve në interpretimin dhe zbatimin e ligjit në fushën administrative, në saj të ekspertizës së tyre
- Një praktikë gjyqësore më e qëndrueshme bën të mundur një siguri ligjore, risjell besimin në shtetin ligjor dhe pakëson çështjet gjyqësore në të ardhmen.

Disa rekomandime

Pavarësisht problematikave që mund të lindin, modeli i një juridiksioni autonom siç është krijimi i gjykatës administrative, do të mundësojë:

- Rregulla të detyrueshme për subjektet e gjykimit administrativ, organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore administrative, si dhe organizimin e gjykatave administrative.
- Garantimin e mbrojtjes efektive të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.
- Krijimin e kushteve të përshtatshme për një shqyrtim efektiv duke vënë në vend të drejtat e cënuara nga veprimet dhe/ apo aktet administrative të nxjerra nga organet publike.
- Sigurinë që çdo qytetar pavarësisht situatës së tij/saj financiare, të ketë akses në drejtësinë administrative.
- Domosdoshmërinë e barazisë së interesit publik nga njëra anë me të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshme të personit nga ana tjetër.
- Forcimin e rolit aktiv të organeve administrative për respektimin e të drejtave subjektive të personave nëpërmjet detyrimit që i vihet organeve publike të provojnë ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes të veprimit administrativ të nxjerrë prej tyre.
- Thjeshtimin e procedurave përkatëse lidhur me gjykimin dhe ekzekutimin vendimeve gjyqësore me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative ndërmjet personave dhe organeve publike.
- Risi në kuadrin e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative lidhur me detyrimin e organeve publike për të paraqitur provat që kanë mundur nxjerrjen e akteve apo kryerjen e veprimeve administrative që më pas kanë sjellë cënimin e të drejtave të ligjshme të personave.
- Zbatimin e parimit se Gjykata Administrativ e gjykon mbi aktet shkresore dhe mosparaqitja e palëve nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit.

BIBLIOGRAFIA

Ligje:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kodi i Procedurës Civile, miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 ndryshuar me ligjin nr. 1052, datë 29.12.2008

Kodi i Procedurës Administrative

Ligji “Për kundravajtjet administrative”

Projekt-ligji për “Organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

Literaturë:

Dobjani.E, “E Drejta Administrative I”, Shtëpia botuese “Perlat Voshtina”, viti 2007

Sadushi.S, “E drejta Administrative”, viti 2006.

Sadushi.S “Teoria e aktit administrativ”, Shtëpia botuese , viti 1999

Wade&Forsyth, Administrative law, viti 1998

Peter Cane, An Introduction to administrative law, viti 1997

Galligan, Discretionary powers, viti 1996

Burime nga interneti:

Faqja e Misionit European te Asistencës për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë:

[http// www.eurallius.org.al](http://www.eurallius.org.al)

Faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë: www.gjykataelarte.gov.al

Qendra e publikimeve zyrtare: www.qpz.gov.al

**THE NECESSITY OF CREATING THE ADMINISTRATIVE COURT, BY
PRESENTING THE CURRENT STATE OF ADMINISTRATIVE DISPUTE
RESOLUTION**

Abstract: This paper deals with the necessity of establishing a new judicial structure, namely the Administrative Court, whose role would be to solve disputes of an administrative nature that often occur between public administration and private entities. The establishment of this structure as part of the judicial system is one of the conditions that our country must meet for EU membership. A comparison is made between the current method of resolving disputes through the specific sections for resolving administrative issues established at the district courts, and solutions that will provide a specialized body such as judicial administrative tribunal. Through analyzing the current situation and the draft for the creation of the Administrative Court, this paper will present the advantages and shortcomings of creating an Administrative Court.

Keywords: Administrative court, public administration administrative dispute, private subjects, legislation.